



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Përgjigje ndaj komenteve të palëve në procesin e konsultimit publik për dokumentin “Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar”

2024

Ky raport është përgatitur nga ZRRE në përputhje me Ligjin për Rregullatorin, lidhur me publikimin e përgjigjeve të ZRRE-së ndaj komenteve të palëve në dokumentin Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar. Në konsultim me palët e interesit dhe në bazë të rishikimit të brendshëm të KOSTT-it, është konsideruar e nevojshme që të bëhen ndryshime të caktuara për ta përmirësuar e Procedurës së Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar dhe për t'iu përshtatur ndryshimeve të pritshme të tregut të energjisë elektrike.

ZRRE ka pranuar nga KOSTT për shqyrtim dhe aprovim dokumentin Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar, ku pas analizimit të tij, të njëjtin e ka vendosur në konsultim publik.

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik, ZRRE ka trajtuar të gjitha komentet e palëve, ku, me ndihmën e konsulencës, komentet janë përfshirë sipas arsyeshmërisë së tyre.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 07.08.2024, ka shqyrtuar dhe aprovuar Procedurën e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar, i cili është publikuar në faqen elektronike të ZRRE.

Komentet dhe Përgjigjet e ZRRE-së

Komentet nga KESCO

Komenti 1:

1.2.2

Fushëveprimi

“Sipas paragrafit 8.1.1 të Rregullave të Tregut, pala duhet të dëshmojë se ka garancion financiar adekuat në favor të OT-së dhe jo OS-së. Prandaj, shtimi i detyrimeve për përdorimin e sistemit është i paarsyeshëm dhe nuk duhet të shtohet në llogaritjet për garancionin financiar”.

Përgjigja e ZRRE-së

KOSTT ka licencë për OT dhe OST. Sipas paragrafit 2.1.2.(b) të Rregullave të Tregut, në veçanti OST do të shfrytëzoj OT si agjent të vet për barazimin përfundimtar financiar për kontratat e shërbimeve të OST dhe inkasimin e të hyrave nga tarifat. Është imperativ që të zvogëlohet ekspozimi ndaj rrezikut për të gjitha obligimet e KOSTT-it, kështu që të gjitha obligimet duhet të përfshihen në llogaritjen e shumës së Garancionit Financiar si për OT ashtu edhe për OST. E gjithë kjo për t'iu shmangur ekspozimit të KOSTT-it ndaj rreziqeve të tilla, që në të kaluarën kanë vështirësuar funksionimin e OT-së dhe OST-së.

Siç specifikohet në paragrafin 8.1.2 të Rregullave të Tregut, kjo procedurë për Garancionin Financiar duhet të kërkojë dispozita që Palët Tregtare të postojnë garancion. Megjithatë, kjo nuk e përjashton përdorimin e faktorëve shtesë, të cilat idealisht do të pritej të ceken në Rregullat e Tregut, por mund të mbulohen nga Procedura siç parashihet në përkufizimin e Garancionit Financiar.

Për më tepër bazuar në Rregullat e Tregut, pika 3.3.6 c, “Aderimi në Rregullat e Tregut, Themelimi i PPB dhe Tërheqja”, tek Palët Përgjegjëse për Balanc (PPB) ndër të tjera thuhet:

..

3.3.6 Një Palë Tregtare mund të aplikoj që të bëhet anëtare e një Grupi Balancues që operohet nga një PPB që është një Palë Tregtare tjetër, në kushtet vijuese:

..

(c) Pala Tregtare aplikuese pajtohet që të ndryshoj të gjitha instrumentet e Garancionit Financiar të saj për ti mundësuar OT mbulimin e kostove për çfarëdo Fature të papaguar të PPB.

Kjo pjesë bën të qartë se subjekt i mbulimit të Garancionit Financiar janë kostot e **çfarëdo fature** të PPB-së.

Prandaj, nga këto që u thanë më lartë komenti i palës nuk pranohet dhe i njëjti nuk përfshihet në dokument.

Komenti 2:

1.2.2 Fushëveprimi

“FSHU duhet të përjashtohet nga garancioni financiar për prokurim të BRE-ve sepse do të liferohet përmes kontratës CfD.”

Përgjigja e ZRRE-së

Marrë parasysh komentin nga ana e palës, ndryshimet në paragrafin bëhen në përputhje me komentin.

Ndryshimi bëhet nga versioni paraprak në: (h) Pagesat e Furnizuesit për Blerje të Energjisë nga BRE që nuk kanë kontratë për diferencë për energjinë e blerë nëpërmjet ALPEX.

Prandaj, nga këto që u thanë më lartë komenti i palës pranohet dhe i njëjti përfshihet në dokument.

Komenti 3:

3.1.2 Vlerësimi i niveleve të çmimeve të jobalancit “Ne e kuptojmë domosdoshmërinë për të rritur garancinë nëse çmimet e imbalanceve rriten. Por kjo metodë do të mbajë çmimin e referencës të lartë për pjesën tjetër të vitit edhe pse çmimet do të vijnë në nivele normale.”

Përgjigja e ZRRE-së

Çmimi sigurues i jobalancit duhet të ndjek rritjen e çmimit të jobalancit. Nëse çmimi nuk rritet, atëherë do të mbetet çmimi mesatar i jobalancit i llogaritur si çmimi mesatar i 12 muajve të fundit, pasi çmimi sigurues i jobalancave mbetet i pandryshuar. Procedura parasheh një monitorim të rregullt të nivelit të Garancionit Financiar si dhe për një rivendosje periodike për të parandaluar ngritjen e vazhdueshme të çmimeve të jobalancit. Kjo vepron si masë parandaluese ndaj shqetësimit të shprehur nga KESCO.

Rillogaritjet vendosen në një pikë çdo vit (tetor) në mënyrë që të mund të ketë një cikël vjetor

për llogaritjen e nivelit të garancionit që nevojitet për çdo pjesëmarrës. Për më tepër, OT mund të rillogarisë nivelin minimal të Garancionit Financiar që kërkohet nga një ose disa Palë Tregtare kur vlen një nga rastet e mëposhtme:

- a. Çmimi Sigurues i Jobalancit është ndryshuar në përputhje me paragrafin 3.1.3; ose
- b. OT kupton që:
 1. përqindja minimale e jobalanceve negative të caktuar në përputhje me paragrafin 3.2.1 rezulton me nivel minimal të Garancionit Financiar për një ose më shumë Palë Tregtare, që paraqet më pak se totali mujor i Pagesave për Jobalancet të cilat duhet ti mbuloj Garancioni Financiar;
 2. përpjesa e kalkuluar në përqindje e konsumit vjetor të energjisë elektrike që i atribuohet një Furnizuesi është për [10%]më e madhe se niveli i kalkuluar (në vitin) paraparak;
 3. që cila do nga: faktori i fuqisë së gjeneratorit, Kapaciteti i Rrjetit për Prodhuesin ose përpjesa e energjisë vjetore e jobalancit negativ të Prodhuesit është rritur për [10%] ose më shumë.

Prandaj, nga këto që u thanë më lartë komenti i palës nuk pranohet dhe i njëjti nuk përfshihet në dokument.

Komenti 4:

3.2.1 Përqindja e mungesës minimale dhe përqindja e korigjimit të tregtarit "Jobalancet veprojnë në dy mënyra dhe mund të jenë obligim edhe për OT. Për të mbajtur kolateralin e jobalancit në nivelin e duhur, duhet të merren parasysh jobalancet pozitive dhe raporti neto i jobalancit duhet të jetë parametri për llogaritjen e kolateralit të jobalancit."

Përgjigja e ZRRE-së

Jobalancet, që janë rrjedhat negative të parasë, nënkuptojnë shumën neto të këtyre rrjedhave. Kjo shumë neto do të përdoret për të llogaritur shumën e garancionit financiar për jobalanc. Llogaritja do të përfshijë tarifën neto për çdo pjesëmarrës, duke përfshirë të gjitha debitimet dhe kreditimet që duhet të paguhen. Sigurisht që jobalancet veprojnë në dy mënyra gjë që kuptohet edhe në artikullimin e paragrafit 3.2.1.

Si rrjedhojë, paragrafi mund të mbetet i pandryshuar për faktin se shqetësimi në komentin e palës veçse është i përfshirë në paragraf.

Prandaj, nga këto që u thanë më lartë komenti i palës nuk pranohet dhe i njëjti nuk përfshihet në dokument.

Komenti 5:

3.3.3 Granacioni financiar minimale i furnizuesve

“12.5% është relativisht e lartë që do të thotë se llogaritja e garancionit financiar do të jetë për 45 ditë, ne propozojmë të ulet numri i ditëve në 30 ditë afërsisht 8%.”

Përgjigja e ZRRE-së

Kjo përqindje lidhet me procedurat e brendshme të faturimit të Operatorit të Tregut (OT) dhe tregon një pjesë të mundshme të vitit, që është 1.5 muaj për llogaritjen e kërkesës për garancion financiar. KOSTT e vlerëson këtë si kostot e mbledhura të jobalancit që mund të grumbullohen mesatarisht përpara se të faturohen nga OT. OT ka konsideruar se është e nevojshme një periudhë prej rreth 45 ditësh për këtë proces, e cila mbulon nga fillimi i muajit deri më 15 të muajit pasues (dita kur lëshohet fatura e energjisë), për të përshkruar një cikël të plotë nga ekzekutimi deri në faturim.

Prandaj, nga këto që u thanë më lartë komenti i palës nuk pranohet dhe i njëjti nuk përfshihet në dokument.

Komenti 6:

3.3.4 Garancioni Finianciar minimal i furnizuesve

“Metodologjia e llogaritjes duhet të përshkruhet qartë. Për momentin nuk tregon një metodë të qartë të llogaritjes.”

Përgjigja e ZRRE-së

Të gjitha shumat duhet të llogariten siç përshkruhet në pikat (a) deri (f) dhe të mblidhen. OS dhe tarifat e tjera të OT të përshkruara në këtë seksion llogariten në baza mujore nga OT dhe llogaritja përshkruhet në mënyrë eksplicite në Rregullat e Tregut.

Prandaj, nga këto që u thanë më lartë komenti i palës nuk pranohet dhe i njëjti nuk përfshihet në dokument.

Komenti 7:

3.3.4 Garancioni Finianciar minimal i furnizuesve “Sipas paragrafit 8.1.1 të Rregullave të Tregut, pala duhet të dëshmojë se ka garancion financiar adekuate në favor të OT-së dhe jo OS-së. Prandaj, shtimi i detyrimeve për përdorimin e sistemit është i paarsyeshëm dhe nuk duhet të shtohet në llogaritjet për garancionin financiar.”

Përgjigja e ZRRE-së

Kjo është sqaruar më lartë në komentin 1.

Prandaj, komenti i palës nuk pranohet dhe i njëjti nuk përfshihet në dokument.

Komenti 8:

3.3.4 Garancioni Financiar minimal i furnizuesve "FSHU duhet të përjashtohet nga garancioni financiar për prokurim të BRE-ve sepse do të liferohet përmes kontratës CfD."

Përgjigja e ZRRE-së

Njëjtë si në komentin 2 komenti i palës është i arsyeshëm.

Prandaj, pranohet komenti i palës dhe i njëjti përfshihet në dokument.

Komenti 9:

4.1.1 Format e pranushme të Garancionit Financiar

"Ne propozojmë të ndryshohet fjalia në: Garancion Financiar nga bankat ose institucione tjera financiare."

Përgjigja e ZRRE-së

Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar është procedurë dhe parimet bazë nuk duhet t'i tejkalojnë ato të përkufizuara në Rregullat e Tregut. Si rrjedhojë komenti i palës nuk pranohet, për më tepër propozimi i KOSTT ndryshohet te Format e Pranueshme të Garancionit Financiar 4.1.1 (b) nga garancionet financiare ndryshohet në garancionet e parevokueshme bankare në mënyrë që të jetë në përputhje me Rregullat e Tregut nën 8.3.1 (b).

Prandaj, nuk pranohet komenti i palës dhe i njëjti nuk përfshihet në dokument.

Komenti 10:

8.1 Shkelje materiale

"Duhet të jetë 3.5.1."

Përgjigja e ZRRE-së

ZRRE pajtohet me vërejtjen. Amendamenti siç është cekur në para. 8.1.1: Dështimi për të mbajtur Garancionin Financiar adekuat është shkelje materiale e dispozitave materiale të Rregullave të Tregut dhe do të trajtohet në përputhje me paragrafin 3.5.1 të Rregullave të Tregut. Prandaj, pranohet komenti i palës dhe i njëjti përfshihet në dokument.